

KARTELE INFORMATIVE				
				AL011062
1. Emri i shërbimit	Kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Pronari i markës së regjistruar, ose aplikanti mund të depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) një kërkesë, kundrejt pagesës së një tarife të caktuar, për regjistrimin ndërkombëtar të markës, në mbështetje të Marrëveshjes së Madridit dhe/ose të protokollit të kësaj marrëveshjeje.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Aplikanti, nëpërmjet një aplikimi të vetëm, mund të kërkojë mbrojtjen e markës në disa vende të botës të zgjedhura nga ai, njëkohësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) shërben si zyrë pritëse dhe vend i origjinës. Në fund të procedurës aplikanti ka siguruar regjistrimin dhe mbrojtjen e markës së tij në vende të ndryshme të botës.			
4. A jam përfitues?	Individ, person fizik apo juridik që ka depozituar një aplikim kombëtar ose ka regjistruar një markë nëpërmjet një aplikimi kombëtar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formulari i përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s	Aplikanti/ WIPO	Po
	2	Formulari për regjistrim ndërkombëtar të markës	Aplikanti/ Institucioni	Po
	3	Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për ekzaminimin dhe përcjelljen e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Banka	Po
	4	Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për llogari të WIPO-s	Banka	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
	☒	☐	☐	☐
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	5 000 lekë	Komisioni bankar		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Menjëherë pas plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	10 vjet			
12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☐	E-albania ☐	Me e-mail ☐
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në:		Orari	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☒	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☐
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		☒	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; Ligji Nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"; VKM Nr. 315, datë 31.05.2018 "Për miratimin e Rregullores për Markat"; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar; Marrëveshja e Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare; Protokolli i Marrëveshjes së Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare.			